



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

## F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e I-rë të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2024.

Seanca mbahet më 26.01.2024 (e Premte), në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën 10:00.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

## RENDI I DITËS:

1. Arsytimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimeve të Komitetit për Politik dhe Financa,
4. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-dhjetor 2023,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2023,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së KKSb-së për vitin 2024,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për zëvendësimin e anëtarit të KKSb-së,
8. Rishqyrtimi i akteve të miratuara nga KK sipas kërkesës së MAPL-së,
  - Vendimi 01Nr.06-40632/23 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të përbashkët të lagjës Balaj në fshatin Sferk,
  - Vendim 01.Nr.06-43402/23 për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik, Lokal në Komunën e Klinës 2024-2029,
9. Pyetje dhe përgjigjeje.

01Nr. 06-1887 2024  
Klinë, me 26.01 2024



Kryesuesi,  
Fadil Gashi